



# REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KUVENDI

### *Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik*

---

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Dokument Parlamentar

### RAPORT

### PËR

## **PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT, PËR THEMELIMIN E QENDRAVE KULTURORE DHE INFORMATIVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË DHE TË QENDRAVE KULTURORE DHE INFORMATIVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT”**

### Hyrje

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, në mbledhjen e tij, të datës 28 janar 2020, mori në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, për themelimin e qendrave kulturore dhe informative në Republikën e Shqipërisë dhe të qendrave kulturore dhe informative në Republikën e Maqedonisë së Veriut”.

Relatore e projektligjit është znj. Vilma Bello.

Në diskutimin në parim të projektligjit ishin të pranishëm dhe dhanë shpjegime rreth tij znj. Entela Çipa, sekretare e përgjithshme e Ministrisë së Kulturës, znj. Elira Dani, drejtoreshë juridike e Ministrisë së Kulturës, z. Sofjan Jaupaj, drejtor i Integritetit në Ministrinë e Kulturës, z. Gentjan Opre, drejtor i Analizës dhe Programimit Buxhetor nga Ministria e Financave, dhe Larisa Bushati, Drejtorja e së Drejtës Ndërkombëtare dhe Evropiane nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

## **I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT**

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të nenit 81, pika 1 dhe 121 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 17 të ligjit nr.43/2018, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, si dhe shoqërohet me relacionin përkatës, sipas nenit 80 të Rregullores së Kuvendit.

## **II. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)**

Ky projektligj nuk parashikon përafrim me *acquis* të Bashkimit Evropian.

## **III. QËLLIMI, PËRMBAJTJA DHE RISITË E PROJEKTLIGJIT**

### **2.1 Qëllimi i projektligjit:**

Projektligji është hartuar në përputhje të plotë me programin politik të Këshillit të Ministrave.

Përmes kësaj marrëveshjeje shprehet angazhimi dhe intensifikimi i marrëdhënieve në fushën e kulturës dhe promovimi i vlerave në fushën e artit dhe shkencës.

Kultura, në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, duhet të përdoret si një instrument i komunikimit të pozitës së Republikës së Shqipërisë në rajon e në botë.

Sipas relacionit shoqërues që në nenin 1 të projektligjit theksohet thelbi i kësaj projekt marrëveshjeje, i cili është krijimi i qendrave kulturore dhe informative të Republikës së Shqipërisë dhe të qendrave kulturore dhe informative të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Puna e qendrave kulturore dhe informative zhvillohet në bazë të normave të së drejtës ndërkombëtare, neneve të kësaj marrëveshjeje dhe në pajtueshmëri me legjislacionin e vendit pritës, ndërkohë që koha e ngritjes së qendrave përcaktohet në bazë të planifikimeve buxhetore të së cilës palë.

Nëpërmjet neneve të tjera të projektligjit përcaktohen qartë mënyra e funksionimit të këtyre qendrave, rolin e secilës palë, për të siguruar qasje të lirë në mjediset e qendrave kulturore dhe informative dhe në manifestimet e organizuara prej tyre, aktivitetet që mund të kryejnë këto qendra kulturore dhe informative, mënyra e financimit, ndihma në bazë të reciprocitetit, çështje që lidhen me personelin e këtyre qendrave etj.

Qendrat do të ngrihen si pjesë e Ambasadës së Republikës së Shqipërisë, e akredituar në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe anasjelltas. Secila prej tyre do drejtohet nga një drejtor, që do emërohet nga qeveria e palës dërguese, ndërsa, nën drejtimin e kreut të misionit diplomatik-konsullor të palës dërguese, financuese e qendrave përkatëse, do kryhen veprimtaritë e tyre. Drejtorët respektivë të secilës prej qendrave kulturore dhe informative që nuk kanë shtetësinë e

vendit pritës, do të jenë mbajtës të pasaportës diplomatike. Personeli tjetër, që nuk ka shtetësinë e vendit pritës, do pajiset me dokumentet zyrtare të udhëtimit.

Emrat zyrtarë të qendrave kulturore dhe informative mund të publikohen në tabela, afishe, formularë, si dhe në korrespondencën, në materialin informativ dhe komunikues.

Qendrat kulturore dhe informative mund të organizojnë në mjediset e tyre aktivitete të larmishme, si: ligjërata shkencore, letrare etj, të cilat shoqërohen sipas rastit me ilustrime vizuale, shfaqje muzikore etj; organizimin e një biblioteke dhe një dhome leximi; shfaqjen e filmave brenda dhe jashtë mjediseve të tyre, me ndërmjetësimin e institucioneve kompetente përkatëse të vendit pritës; organizim të ekspozitave të fotografive, veprave origjinale ose riprodhimeve të artit; shkëmbimin e programeve televizive dhe të radios, në përputhje me marrëveshjet e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve informuese të Palëve etj.

Qendrat kulturore dhe informative do veprojnë sipas ligjeve në fuqi të shtetit në të cilin ato janë vendosur. Këto qendra janë shtetërore; mënyra e financimit të tyre përcaktohet nga secila palë kontraktuese.

Palët, në bazë të reciprocitetit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi të tyre, do lirojnë qendrat kulturore dhe informative nga pagesa e detyrimeve doganore, të taksave për kushtet e magazinës dhe kushtet e një natyre të ngjashme, në përputhje me masën që përcaktohet në dispozitat e Konventës së Vjenës për mallrat e importuara që nuk janë në shitje, si: katalogët, afishet, njoftimet, librat etj; mallrat për import të përkohshëm: pajisje teknike, mobiljet etj; filmat, të projektuar në ambientet e qendrave kulturore dhe informative ose jashtë tyre, si dhe çdo lloj materiali me natyrë kulturore dhe informuese, i nevojshëm për funksionimin e qendrave kulturore dhe informative.

Të ardhurat e qendrave kulturore dhe informative janë në përputhje me legjislacionin tatimor të vendit pritës, si dhe në përputhje me marrëveshjet ekzistuese dypalëshe ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Përmes këtij projektligji parashikohen dhe një sërë aspektesh të tjera dobiprurëse të qendrave kulturore dhe informative.

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohet Ministria për Evropën e Punët e Jashtme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Kulturës.

Kryetarja e Komisionit, Znj. Fatjona Dhimitri u shpreh se mbështet çdo marrëveshje e cila i shërben shkëmbimit të eksperiencave kulturore. Ndër të tjera u theksua që marrëveshja nuk duhet të transmetojë dhe të jetë në funksion të interesave politike, pasi vendi ynë ende nuk e ka kapërcyer gjendjen e fatkeqësisë natyrore dhe pasojat e lëna nga tërmeti i 26 Nëntorit, çka e bën të vështirë dhe evidentimin e buxhetit përkatës për hapjen e këtyre qendrave. Ministrisë së Financave iu kërkua sjellja e një tablele përkatëse për evidentimin e zërave të shpenzimeve për hapjen e qendrave.

Duke patur parasysh misionin mjaft dobiprurës të këtij projektligji, vlerat e shumanshme të tij, ratifikimi i kësaj marrëveshjeje do t'i shërbejë përsosjes gjithnjë e më shumë të punës të institucioneve që ngarkohen për zbatimin e saj.

Mbështetur në argumentat e mësipërme dhe rëndësinë e marrëveshjes, Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, me votat e të gjithë anëtarëve, miratoi projektligjin dhe u shpreh dakord për kalimin e tij për votim në seancë plenare.

**RELATORE**

**Vilma BELLO**

**KRYETARE**

**Fatjona DHIMITRI**